



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:181187

Datë: 28.04.2023

Numri i dokumentit: 04235772

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.15/21

GJYKATA THEMELORE PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me procesmbajtëse Shpresa Kërnja në çështjen penale kundër të pandehurit M. D. nga Peja, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2175/20 të datës 11.01.2021 për shkak të veprës penale Ndërtim pa leje nga neni 359 par.3 lidhur me par .2 të KPRK-së, veprën penale Pengim i personit zyrtar ne kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 401 par.1 të KPRK-së dhe veprën penale Hiqja apo dëmtimi i vulave ose shenjave nga neni 406 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 18.04.2023 në prezencë të prokurorit së shtetit Dorjan Juniku dhe të pandehurit M. D. me mbrojtës Av.Gani Shala me datë 20.04.2023 shpalli dhe me datë 28.04.2023 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

M. D. i atësisë H. dhe amësisë G. e vajzërisë K., i lindur me në Pejë, ku edhe jeton, rr “A. Gj.”, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr., i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, posedon nr. të telefonit 045-...-..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

- I. Më parë e gjerë me dt. 21.10.2020, në kohë të pacaktuar në Pejë, si pronar, ndërton objekt pa leje për të cilin kërkohet leja e tillë në bazë të ligjit për ndërtim dhe atë nenit 7 dhe 14 ani pse Inspektorët e ndërtimit, këtu dëshmitarët B. M. dhe D. Gj.i kanë lëshuar procesverbalin për ndalim të punimeve me dt. 13.10.2020, i pandehuri në

vendin e lartcekur kishte vazhduar me ndërtim të shtëpisë, për të cilën nuk kishte leje nga organet Komunale, ashtu që i njëjti edhe përkundër kësaj me datën 21.10.2020 ka vazhduar me ndërtimin e objekti.

- me këtë ka kryer veprën penale “Ndërtimi pa leje” nga neni 359 par. 3 lidhur me par. 2 të KPRK-së.

II. Me dt. 21.10.2020, rreth orës 11:55 minuta, në Pejë, në rr “V.t Gj.” me forcë dhe kanosje pengon personat zyrtar në kryerje të detyrave zyrtare dhe atë të dëmtuarin-Inspektorin e Ndërtimit, D. Gj., në atë mënyrë që i pandehuri e sulmon Inspektorin e lartcekur, ku fillimisht e fyen e më pas ia hedhë dokumentet zyrtare në tokë, si dhe i drejtohet me fjalët kërcënuese “nëse më rrezohet shtëpia ime, do të rrezohet edhe shtëpia jote dhe do të të kalli me gjithë familjen” dhe kjo për faktin se i dëmtuari së bashku më dëshmitarin B. M. kishin shkuar tek shtëpia e të pandehurit M. me qëllim të inspektimit pasi që me dt. 13.10.2020 ia kishin lënë një procesverbal për ndalimin e punimeve, dhe me qëllim që të njëjtit t’ia dorëzojnë vendimin për rrënim.

-me çka ka kryer veprën penale “Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare” nga neni 401 paragrafi 1 të KPRK-së.

III. Me dt. 01.11.2020, rreth orës 16:40 minuta në Pejë, në rr “V. G.”, me dashje heq shenjën e ngjitur nga zyrtari i autorizuar me qëllim të sigurimit të objektit, në atë mënyrë që pasi Inspektorët e ndërtimit, këtu dëshmitarët B. M. dhe D. Gj. kishin shkuar në vendin e lartcekur, ku i pandehuri ishte duke ndërtuar shtëpinë pa leje ndërtimit, e për çka me dt 13.10.2020 ia kishin lëshuar vendimin për ndalimin e punimeve duke ia vendosur shenjat zyrtare të cilat përcaktojnë ndalimin e punimeve pa leje, ashtu që i pandehuri edhe përkundër këtij fakti me dt. të sipërshënuar heq shenjat e ngjitura nga zyrtarët e autorizuar.

-me çka ka kryer veprën penale “Heqja apo dëmtimi i vulave ose i shenjave” nga neni 406 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 43, 46, 48, 49,69, 70 dhe 76 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

I. Të pandehurit M. D. i shqipton:

- Për veprën penale si ne pikën I. të dispozitivit të aktgjyqimit DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 1 (një) viti si dhe DENIM ME GJOBË në lartësi prej 500 (pesëqind) euro.
- Për veprën penale si në pikën II. të dispozitivit të aktgjyqimit DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh.
- Për veprën penale si në pikën III. të dispozitivit të aktgjyqimit DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh.

II. Të pandehurit i përcaktohet dënimi unik DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, si dhe DENIM ME GJOBË në lartësi prej 500 (pesëqind) euro, të cilat dënime KUSHTËZOHEN, nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. RRENOHET objekti i ndërtuar pa leje, i përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të aktgjyqimit, shpenzimet për rrenim i bart i dënuari.

IV. Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

V. Kërkesë pasurore juridike nuk pati nga pala e dëmtuar.

ARSYETIM

A. Historiku i çështjes dhe vendimi në lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 11.01.2021 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2175/21 kundër të pandehurit M. D. për shkak të veprës penale Ndërtim pa leje nga neni 359 par.3 lidhur me par .2 të KPRK-së, veprën penale Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 401 par.1 të KPRK-së dhe veprën penale Hiqja apo dëmtimi i vulave ose shenjave nga neni 406 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 18.04.2023 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku ,i pandehuri M. D. me mbrojtës Av.Gani Shala dhe i dëmtuari D. Gj., në të cilën seancë i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprat penale që i vihet në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe mbrojtëses se te pandehurit , në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Pas aprovimit të pranimin të fajësisë nga ana e gjykatës, prokurori i shtetit deklaroi “ Me qenë se i akuzuari bëri pranimin e fajësisë Konform kriterëve ligjore të përcaktuara me nenin 242 të KPPRK-së, nga Gjykata kërkohet që të njëjtin ta shpallë fajtor, ta dënoj sipas ligjit si dhe ta obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese, ndërsa në kuptim të dispozitave ligjore neni 70 të KPPRK-së. Si rrethana rënduese të vlerësoj shkallën e lartë të pjesëmarrjes në kryerje të veprës, nga se i pandehuri i ka kryer tri vepra penale si dhe shkallën lartë të dashjes për faktin se i njëjti është pajtuar dhe e ka dashur që të shkaktohen më shumë pasoja, në rastin konkret tri sosh të përshkruara si në aktakuzë”.

Mbrojtësi i të pandehurit Av.Gani Shala deklaroi “Pasi që mbrojturi im e bëri pranimin e fajësisë në mënyrë vullnetare kërkohet që Gjykata ta merr si rrethanë veçanërisht lehtësuese duke pas parasysh që i njëjti i kërkon falje palës së dëmtuar, dhe duke pas parasysh edhe gjendjen e tij ekonomike kërkohet që Gjykata ti shqiptoj një dënim të kushtëzuar”.

I pandehuri M. D. deklaroi “ E përkrahi deklarinimin e mbrojtësit tim në tërësi dhe shprehi keqardhje për rastin që ka ndodhur, posaçërisht palës së dëmtuar këtu prezent i kërkohet falje dhe deklarohet se ka qenë thjesht një moment nervoze”.

B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42,43, 46, 48, 49,69,70 dhe 76 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese të çështjes.

Për veprën penale me të rendë për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim unik për tri vepra penale, dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e gjashtë (6) muaj si dhe dënim me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin nuk kemi fare rrethana renduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dënimin më gjobë gjykata e shqiptoj duke u bazuar në faktin se për vepër penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë shqiptimin e dënimit me gjobë dhe me burgim në mënyrë kumulative, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 43 par.1 dhe 2 të KPRK-së vendosi që të pandehurit t'i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, më bindjen se ky dënim se bashku me dënimin me burgim, do të arrijnë në mënyrë të mjaftueshme të shprehin gjykimin shoqëror për veprën e kryer.

Gjykata të pandehurit i shqiptoj dënim për të tri veprat penal se dhe atë për veprën penale si në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti si dhe dënim me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) euro, për veprën penale si në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh dhe për veprën penale si në pikën III. të dispozitivit të aktgjykimit dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh.

Si rrjedhojë në kuptim të nenit 76 par.2 pika 2.2. të KPRK-së të pandehurit i shqiptoj dënim unik, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, si dhe dënim me gjobë ne lartësi prej 500 (pesëqind) euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimeve gjykata u bazua në nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kushtëzues ndaj të pandehurit M. D. do të arrihet të realizohet në tersi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikojë në rehabilitimin e të pandehurit, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit . Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej dy (2) vitesh do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënimi me burgim dhe gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandalojë të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kushtëzues në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kushtëzim mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e në këtë rast siç u përshkrua më lartë për veprën penale me tërësi që është shpallur fajtor i pandehuri është paraparë mundësia e shqiptimit të dënimit me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit M. D. është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shpreh gjykimin shoqëror për veprat penale të kryera nga i pandehuri.

Kur u vendos për rrënimin e objektit të ndërtuar pa leje e të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi në bazë të nenit 359 par.5 të KPRK-së ku është paraparë se “Ndërtimi pa leje në këtë nen duhet të rrënohet dhe shpenzimet e rrënimin barten të kryesi”, pra dispozita materiale ka paraparë që objekti i ndërtuar pa leje duhet që të rrënohet dhe kjo nuk është dispozitë alternative për gjykatën për është normë obligative.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Kërkesë pasurore juridike nuk pati nga i dëmtuari, siç parashihet nenin 458 par.1 të KPRK-së, si rrjedhojë gjykata nuk vendosi për kompensim të dëmtuarit e as nuk e udhëzoi në kontest civil të dëmtuarin.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.15/21, me datë 28.04.2021

Procesmbajtësja:

Shpresa Kërnya

Gjyqtari i vetëm gjykues:

Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.